

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS

Nr. 34 prot

Kukës me , 29 / 09 / 2014

KONTRATË PËR DREJTIM PUNIMESH
(SUPERVIZION I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT)

Kjo kontratë lidhet sot me date 29.09.2014 ndërmjet palëve :

❖ **Investitori** Bashkia Kukës e përfaqësuar nga Kryetari
Z. Hasan Halilaj

❖ **Drejtuesi I punimeve "Izet Spahiu".P.F.**

E pefaqesuar me prokure nga Ing.Izet Spahiu.

❖ **Objekti I Kontratës** Drejtim I punimeve (Supervizion) në Objektin
" Ndertim I Kendive Sportive te shkollave 9-ujecare "Bajram Curri dhe Riza Spahiu" Kukës

❖ **Baza Ligjore** Ligji nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" U.K.M nr.3 dt.15.03.2001 me ndryshimet e mevoneshme si dhe në bazë Ligjit 7850 dt 29.07.1994 (I ndryshuar) neni 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 "Per prokurimin publik" I ndryshuar.

I- Kushte të përgjithshme .

a- Drejtuesi I punimeve (Mbikqyres punimeshi) do të ushtrojë aktivitetin e tij në përputhje me ligjin nr. 8402 dt. 10.09.1998 " Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit " , Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 dt. 15.03.2001 me ndryshimet e mevoneshme .

b- Drejtimi I punimeve të objektit në fjalë ka për qëllim kontrollin dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve , bazuar në projekt-zbatimin e hartuar nga ana e Bashkisë Kukës conform KTP dhe KTZ .

c- Mbikqyres i punimeve është I detyruar të njohë dhe të veprojë në praktikë konform të gjitha detyrimeve që rrjedhim nga zbatimi I ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 Kreu I , II , III si dhe të Udhëzimit nr. 3 dt. 15.03.2001 , Kap I , pikat 1 deri 21 . Mos zbatimi I tyre përbën shkelje dhe mbi të vepronë sanksionet sipas Nenit 15 deri 17 të ligjit 8402 dt. 10.09.1998.

d- Në veçanti Mbikqyres i punimeve, që të ushtrojë veprimtarinë e tij , nuk duhet të ketë asnjë lidhje interesi , gjaku apo pune me zbatuesin e punimeve të objektit dhe për këtë deklaron me shkrim me përgjegjësi personale para fillimit të punës së objektit .

e- Pagesa e supervisorit do të jetë 95.000 Leke me tvsh ne baze te Urdhete te Prokurimit me Blerje te Vogla Nr 29 date 17.09.2014.

II- Kushte të Veçanta

A- Detyrimet e investitorit

- ❖ Investitori do të pajisë Mbikqyresin e punimeve me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës të objektit
- ❖ Investitori mund te kerkoje largimin e mbikqyresit te punimeve kur veren shkelje ne veprimatarine e tij.
- ❖ Investitori ka te drejte te kontrolloje dokumentacionin e paraqitur nga drejtuesi i punimeve.

B- Detyrimet e Mbikqyresit te punimeve

- ❖ Mbikqyresi punimeve është një ndër personat kryesorë përgjegjës për ndjekjen e punimeve të ndërtimit të objektit .
- ❖ Mbikqyresi i punimeve mban , kontrollon dhe përgjigjet për dokumentacionin bazë për ndërtimin e objektit si Projekt-zbatimin dhe preventivin e punimeve që duhet të jenë të firmosur nga Projektuesi .
- ❖ Për punimet e maskuara mban proces-verbalet përkatëse dhe i paraqet së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor të objektit në përfundim të punimeve të zbatimit .
- ❖ Kontrollon plan organizimin e punimeve si dhe dokumentacionin për ndryshimet e mundëshme që mund të bëhen në objekt gjatë ndërtimit .
- ❖ Kontrollon librin e kantierit dhe përgjigjet për vertetësinë e dokumentave
- ❖ Duhet të njohë dhe zbatojë rigorozisht kushtet e kontratës së Sipërmarrjes të përcaktuara sipas Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3 dt. 15.02.2001 në pikat 6 deri 19 .
- ❖ Mbikqyresi i punimeve ka per detyre te njoftoje sipermaresin per difektet e vena re dhe kohen e korrigjimit te tyre, me shpenzimet e veta .Punimet me difekte nuk do te pranohen deri ne korigjimin e tyre.

- ❖ Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te ndrprese punimet per arsye te ndikimit te kushteve klimatike ne to, kundrejt nje zgjatje koresponduese te afatit.
- ❖ Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te urdheroje drejtorin e punimeve te sipermaresit te prish dhe te ribej me shpenzimet e sipermarresit brenda periudhes se korigjimit te difekteve punimet qe rezultojne me shkelje te kushteve teknike te zbatimit ,standarteve e specifikimeve teknike.
- ❖ Mbikqyresi me kerkese te Sipermaresit verteton me procesverbal daten e perfundimit te punimeve sipas projektit te ndryshimeve te urdheruara e kushteve te kontrates.

III- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate , ne rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim , atëherë palët I drejtohen Gjykatës së rrethit Kukës .
 Pasi palët u njohën me kushtet e kësaj kontrate , duke pranuar kushtet e saj , e firmosën me vullnet të lire . Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) kopje , një prej të cilave futet në dosjen e objektit .

MBIKEQYRESI I PUNIMEVE

"Izet Spahiu".P.F

E pefaqesuar nga:


Ing.Izet SPAHIU



PËR INVESTITORIN

KRYETARI I BASHKISË KUKËS

Hasan HALILAJ



Konceptoi
Besmir Bilali